



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë më, ____ . ____ . 2025

NJOFTIM

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kërkon të marrë me qira ambient për vendosjen/ruajtjen/parkimin e 100 automjeteve

Fondi Limit për m² është 1 (një) euro ose 97 (nëntëdhjetë e shtatë) lekë për m²

Ambienti që do të merret me qira nga ana e DPT, duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

➤ **Sipërfaqe Open Space e mjaftueshme për parkimin dhe ruajtjen e rreth 100 (njëqind) automjeteve :**

Ambienti duhet të jetë i përmasave të tilla që të mundësojë akomodimin e një numri të konsiderueshëm automjeteve, me një kapacitet orientues prej rreth 100 automjete. Për këtë arsye, ambienti duhet të ketë kapacitet të përshtatshëm dhe të adaptueshëm, për të garantuar jo vetëm vendosjen fizike të mjeteve, por edhe qasjen logjistike dhe funksionalitetin operativ në çdo moment.

➤ **Duhet të ketë një sipërfaqe minimumi 1700 m² dhe maksimumi 2000 m²:**

Ky vlerësim është marrë si vlerë mesatare duke qenë se automjetet që konfiskohen mund të jenë modeleve të ndryshme si automjete të vogla, automjete të mëdha dhe mjete të specializuara. Për këtë arsye, sipërfaqja e kërkuar duhet të jetë e mjaftueshme për të akomoduar jo vetëm numrin e mjeteve, por edhe diversitetin e përmasave dhe llojeve, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për parkim të sigurt, manovrim, inspektim dhe transport.

➤ **Të ketë rrethim fizik me mur/gardh për siguri e garantuar dhe të jetë tokë e shtruar (me beton/asfalt/ çakull me rul):**

Automjetet e konfiskuara janë pasuri të cilat konfiskohen me qëllim shitjen në ankand publik në funksion të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara. Rrethimi fizik me mur/gardh është i domosdoshme për të parandaluar vjedhje, dëmtime apo ndërhyrje të paautorizuara.

➤ **Të ketë akses në rrugë kryesore/urbane për transportin e automjeteve me karotrec:**

Automjetet e konfiskuara do duhet të transportohen me karotrec. Ambienti duhet të ketë hyrje të gjerë, pa pengesa, dhe rrugë të përshtatshme për mjete të rënda, për të mundësuar futjen dhe

daljen pa rrezik dëmtimi. Kërkohej që ambienti të mos ndodhet në zona të ngushta, të vështira për manovrim.

➤ **Të ketë vendndodhje jo më larg se 18 km në vijë ajrore nga godina kryesore e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ndodhet në Tiranë dhe operon kryesisht në këtë zonë. Një ambient jo më larg se 18 km në vijë ajrore siguron efikasitet në menaxhim, inspektim, dhe ulje të kostove logjistike për transportin e mjeteve dhe personelit.

➤ **Ambienti duhet të jetë me dokumentacion të rregullt pronësie:**

Ambienti duhet të ketë dokumenta të rregullta ligjore, të mos ketë barrë hipotekore, sekuestro ose çdo dokument tjetër me të cilin vërtetohet posedimi i ambientit.

➤ **Objekti duhet të ketë furnizim të rregullt energji elektrike me matës të dedikuar dhe të ketë sistem/pajisje kundra zjarrit**

Duke qenë se për të ruajtur sigurinë e ambientit do të instalohen kamera sigurie duhet të ketë energji elektrike dhe për të shmangur situata të paparashikuara si zjarri duhet të ketë pajisje kundra zjarrit.

Dokumentacioni “Kriter Vlerësimi” nga ana e Komisionit:

1. Certifikatë pronësie, hartë treguese dhe kartelë e rifreskuar e pasurisë së paluajtshme (kartela duhet të jetë lëshuar jo më herët se 3 muaj para publikimit të njoftimit);
2. Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë:
 - Për personat fizik në kuptim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
 - Për personat juridik në kuptim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (P.F, SH.P.K, SH.A etj):
 - Vërtetim për administratorin
 - Vërtetim për aksionarin
3. Vërtetim e Verifikimit të Gjëndjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti):
 - Për personin fizik në kuptim të Kodit civil (pronar toke);
 - Për personat juridik në kuptim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (P.F, SH.P.K, SH.A etj)
 - Vërtetim e Verifikimit të Gjëndjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) për administratorin.
 - Vërtetim e Verifikimit të Gjëndjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) për aksionarin.
4. Dokument identifikimi i pronarit të objektit (pasaportë ose kartë identiteti)/Ekstrakt Historik për Personat Juridik sipas Kodit Civil.
5. Vërtetim bankar IBAN.
6. Ofertë ekonomik mbi çmimin për m².
7. Vërtetim mbi pagesën e taksës së tokës/vendore.
8. Për personin fizik në kuptim të Kodit Civil vërtetim nga Administrata Tatimore që nuk ka detyrime, nëse është subjekt deklarimi sipas ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 67 “Deklarata vjetore e të ardhurave personale”.

9. Për personat juridik në kuptim Kodit Civil vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore koherente.
10. Vërtetim nga “Furnizuesi i Shërbimit Universal” se subjekti nuk ka detyrime të palikujduara për ambientin.
11. Deklaratë shoqëruar me Foto për “Sipërfaqe Open Space e mjaftueshme për parkimin dhe ruajtjen e rreth 100 (njëqind) automjeteve”.
12. Deklaratë shoqëruar me Foto për “Të ketë rrethim fizik me mur/gardh për siguri e garantuar dhe të jetë tokë e shtruar (me beton/asfalt/ çakull me rul)”.
13. Deklaratë shoqëruar me Foto për “Të ketë akses në rrugë kryesore/urbane për transportin e automjeteve me karotrec”.
14. Deklaratë shoqëruar me foto për pajisjet kundër zjarrit.

Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në formën e tij ligjore original ose kopje e noterizuar.

Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj kundrejt lëshimit të faturës tatimore.

- Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve tatimore do të kryhet nga DPT, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat e tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.

Objekti që do të merret me qira duhet t'i vihet në dispozicion qiramarrësit brenda 5 ditëve nga njoftimi për lidhje kontrate.

Dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet deri në datën 03.10.2025, ora 12:00, në zyrën e protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në adresën Rruga “Gjin Bue Shpata”, pranë Stadiumit Dinamo.

Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

***Sqarim: Lidhur me kërkesën “Duhet të ketë një sipërfaqe minimumi 1700 m² dhe maximumi 2000 m², në rast se ofertuesi ofron një sipërfaqe më të madhe se ajo e kërkuar nga DPT, objekti i kontratës dhe detyrimet financiare që rrjedhin prej saj lidhen vetëm me sipërfaqen prej 2.000m²”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,